



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2246/2 prot.

Pukë, më 06.01. 2025

VENDIM

Nr. 70 datë 27.12.2024

PËR

**“ KRIJIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR MEDALJET DHE TITUJT  
VENDOR TË NDERIT NË BASHKINË PUKË”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, neni 9 neni 54, si dhe ligjin nr. 94/2022 “Për Titujt e Nderit dhe Titujt Vendor të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë , Këshilli i Bashkisë Pukë në mbledhjen e tij, me datë 27.12.2024 pas shqyrtimit ;

**VENDOSI:**

1. Të ngrihet Komisioni Këshillimor për Medaljet dhe Titujt Vendor të Nderit të Bashkisë Pukë, i përbërë nga:
  - Sokol Gjoni
  - Denisa Meçi
  - Endrit Kraja
  - Rasim Laçi
  - Ylli Hadroj
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkisë Pukë,
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”
4. Vendimi u shpall me date 06.01.2025.

Vota te vlefshme gjithsej : 11

Vota pro 11 , vota kunder 0, vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA



22.01.25 H. Terbuco



2246/4  
27.01.2025  
REPUBLICA E SHQIPËRISË  
SEKRETARIA  
BASHKIA PUKË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr 34/1 prot.

Shkodër, më 27.01.2025

**LËNDA:** Mbi vendimin Nr.70, datë 27.12.2024 të Këshillit të Bashkisë Pukë.

**KËSHILLIT TË BASHKISË PUKE**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175 dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 13/2, neni 55/2/6, neni 64/c, neni 14 i ligjit Nr. 94/2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.9270/2004 “Për sistemin e adresave” i ndryshuar, VKM Nr.861 datë 16.12.2014 “Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimore për dhënien e medaljeve dhe titujve vendore të nderit në Republikën e Shqipërisë”, **u njoh me VKB Pukë nr.70 datë 27.12.2024 “Për krijimin e komisionit këshillimor për medaljet dhe titujt vendore të nderit, në Bashkinë Pukë”, akt me karakter jo normativ.**

Emrat e përfitueseve (nominalisht) nuk përfshihen në kategorinë e akteve normative për të cilat Prefekti në zbatim të nenit 8, shkronja “a” e ligjit “Për Prefektin” i ndryshuar, ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

